



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 167 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 167 Akti, datë 13.01.2020, si më poshtë:

KËRKUES: **Bashkia e Tiranës**

OBJEKTI: *Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3806, datë 19.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 2119, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Znj. Hamide Tali**

I PADITUR: **Këshilli Ministrave
Ministria e Brendshme
Bashkia Tiranë**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3806, datë 19.07.2016 ka vendosur ndër të tjera: “- *Ndryshimin e VKM-së nr. 752, datë 05.09.2013 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Bulevardi Verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”, përsa i përket paditësive në lidhje me pikën 18, objekti në hartë me nr. 7/1, duke përcaktuar si masë shpronësimi vlerën 10.432.500 Lekë. – Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë në favor të palës paditëse diferencën mes shumës së përcaktuar 10.432.500 Lekë dhe asaj të përcaktuar me VKM në lidhje me pikën 18, objekti në hartë me nr. 7/1 - Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin Nr. 2117, datë 04.07.2019 ka vendosur: “*Ndryshimin e VKM-së nr. 752, datë 05.09.2013 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”, në pikën 18, përsa i përket vlerës së akorduar paditësve, nga 1.707.461 Lekë, në 7.355.400 Lekë. – Detyrimin e të paditurit, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësve shumën 1.815.824.4 Lekë. – Rrëzimin e pjesës tjetër të padisë.”.*

3. Kundër Vendimit Nr. 2117, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë.

4. Me datë 13.01.2020 pala e paditur gjyqumbëse, Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e vendimit të formës së prerë, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave të faktit janë haptazi në kundërshtim me provat dhe me ligjin, pasi shpronësimi me vlerën e tregut nuk është shpërblim i drejtë sikurse kërkon ligji;*
- *Vlera që është nxjerrë pas procedurës së shpronësimit bazohet tek metoda e kostos mesatare të ndërtimit në qytetin e Tiranës sipas udhëzimit të nxjerrë për këtë qëllim nga Enti Kombëtar i Banesave për çdo punim të kryer nga pala paditëse;*
- *Prona e palës paditëse nuk ka qenë me dokumenta pronësie që do të thotë se sendi nuk mundet të qarkullojë civilisht i lirë;*
- *Vlerësimi i bërë si vlerë kompensimi për pronën nuk është arbitrar;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur dhe se ka rrezik që titulli ekzekutiv të ekzekutohet menjëherë;*
- *Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë mundet të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe ka efekte financiare të konsiderueshme;*
- *Vendimet e gjykatave të faktit duhet të pezullohen derisa çështja të shqyrtohet në Gjykatën e Lartë.*

5. Ekzekutimi i detyrueshëm nga nisur nga shërbimi përmbarimor. Kolegji ka vendosur të procedojë paraprakisht me njoftimet e palëve. Rezulton se ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur nga shërbimi përmbarimor.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkia Tiranë për pezullimin e Vendimit Nr. 3806, datë 19.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 2119, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 167 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 167 Akti, datë 13.01.2020, si më poshtë:

KËRKUES: **Bashkia e Tiranës**

OBJEKTI: *Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 3806, datë 19.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 2119, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Znj. Hamide Tali**

I PADITUR: **Këshilli Ministrave
Ministria e Brendshme
Bashkia Tiranë**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I. Rrethanat e faktit

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3806, datë 19.07.2016 ka vendosur ndër të tjera: “- *Ndryshimin e VKM-së nr. 752, datë 05.09.2013 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Bulevardi Verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”, përsa i përket paditësive në lidhje me pikën 18, objekti në hartë me nr. 7/1, duke përcaktuar si masë shpronësimi vlerën 10.432.500 Lekë. – Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Tiranë, të paguajë në favor të palës paditëse diferencën mes shumës së përcaktuar 10.432.500 Lekë dhe asaj të përcaktuar me VKM në lidhje me pikën 18, objekti në hartë me nr. 7/1 - Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin Nr. 2117, datë 04.70.2019 ka vendosur: “*Ndryshimin e VKM-së nr. 752, datë 05.09.2013 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Bulevardi verior dhe rehabilitimi i lumit të Tiranës, Bashkia Tiranë”, në pikën 18, përsa i përket vlerës së akorduar paditësve, nga 1.707.461 Lekë, në 7.355.400 Lekë. – Detyrimin e të paditurit, Bashkia Tiranë, t’i paguajë paditësve shumën 1.815.824.4 Lekë. – Rrëzimin e pjesës tjetër të padisë.”.*

3. Kundër Vendimit Nr. 2117, datë 04.70.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimin e padisë.

4. Me datë 13.01.2020 pala e paditur gjyqumbëse, Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e vendimit të formës së prerë, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave të faktit janë haptazi në kundërshtim me provat dhe me ligjin, pasi shpronësimi me vlerën e tregut nuk është shpërblim i drejtë sikurse kërkon ligji;*
- *Vlera që është nxjerrë pas procedurës së shpronësimit bazohet tek metoda e koston mesatare të ndërtimit në qytetin e Tiranës sipas udhëzimit të nxjerrë për këtë qëllim nga Enti Kombëtar i Banesave për çdo punim të kryer nga pala paditëse;*
- *Prona e palës paditëse nuk ka qenë me dokumenta pronësie që do të thotë se sendi nuk mundet të qarkullojë civilisht i lirë;*
- *Vlerësimi i bërë si vlerë kompensimi për pronën nuk është arbitrar;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur dhe se ka rrezik që titulli ekzekutiv të ekzekutohet menjëherë;*
- *Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë mundet të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe ka efekte financiare të konsiderueshme;*
- *Vendimet e gjykatave të faktit duhet të pezullohen derisa çështja të shqyrtohet në Gjykatën e Lartë.*

5. Ekzekutimi i detyrueshëm nga nisur nga shërbimi përmbarimor. Kolegji ka vendosur të procedojë paraprakisht me njoftimet e palëve. Rezulton se ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur nga shërbimi përmbarimor.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkia Tiranë për pezullimin e Vendimit Nr. 3806, datë 19.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me Vendimin nr. 2117, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 3/185 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 185 Akti, datë 25.03.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/
Ndërtimeve Informale**

OBJEKTI: *Pezullimi i ekzekutimit të Vendimit nr. 861, datë 09.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 258, datë 01.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Z. Naim Rrafmani**

I PADITUR: **Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/
Ndërtimeve Informale**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 861, datë 09.03.2018 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi*

Naim Rrafmani. – Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim nr. 2822, datë 31.08.2017 “Për kualifikimin e ndërtimit informal” të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI Tirana Jug. – Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” nr. 16, datë 15.09.2017 të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. – Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim “Për dënim me gjobë” nr. 10., datë 15.09.2017 të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. - Detyrimin e palëve të paditura Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Rajonale e ALUIZNI Tirana Jug, që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësin Naim Rrafmani në shumën 6.973.200 Lekë.”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 258 (86-2019-286), datë 01.02.2019 ka vendosur: *“1. Ndryshimin e Vendimit nr. 861, datë 09.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Pranimin e padisë. 3. Shfuqizimin e pjeshëm të aktit administrativ, Vendim nr. 2822, datë 31.08.2017 “Për kualifikim ndërtimi informal” të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Tirana Jug, vetëm për sipërfaqen 80.8 m² si në kundërshtim me ligjin. 4. Shfuqizimin e pjeshëm të aktit administrativ mendim “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”nr. 16, datë 15.09.2017 të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, për sipërfaqen e objektit 80.8 m² si një akt në kundërshtim me ligjin. 5. Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendim “Për dënim me gjobë”, nr. 10, datë 15.09.2017 të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. 6. Detyrimin e palëve të paditura, Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana Jug që të dëmshpërblejë në mënyrë solidare paditësin, Naim Rrafmani, në shumën 6.302.400 Lekë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 258 (80-2019-286), datë 01.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, ALUIZNI. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrezimi i padisë si e papabuar në ligj.

4. Më datë 25.03.2019 Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Pala e paditur ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëherë do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur. Kolegji Administrativ vendosi të procedojë me njoftimin paraprak të palëve.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale kundër Vendimit Nr. 861, datë 09.03.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr. 258 (86-2019-286), datë 01.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 188 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 188 Regj., datë 14.02.2020, si më poshtë:

KËRKUES: Dega e Doganës Vlorë

OBJEKTI: *Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2663, datë 02.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të ndryshuar me Vendimin nr. 885, datë 21.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.*

Në çështjen me palë:

PADITËS: Nutri Farm sh.p.k.

I PADITUR: Dega e Doganës Vlorë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me Vendimin nr. 2663, datë 02.10.2012** ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë, duke shfuqizuar aktin administrative Vendim nr.*

200/1, datë 27.07.2010, i Degës së Doganës Vlorë. – Rrëzimin e padisë si të pabazuar në për sa i përket kërkimit për shpërblimin e dëmit.”.

2. **Gjykata e Apelit Vlorë me Vendimin nr. 230, datë 05.04.2013** ka vendosur: “- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2663, datë 02.10.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë që ka vendosur pranimin e padisë duke shfuqizuar Vendimin nr. 200/1, date 27.07.2010 të Degës së Doganës Vlorë.”.

3. **Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 240 (00-2016-1482), datë 21.04.2016** ka vendosur: “Prishjen e Vendimit nr. 230, datë 05.04.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Administrativ.”.

4. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 885 (15120/10332/5181/1700 akti), datë 21.03.2019** ka vendosur: “Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 200/1 datë 27.07.2010 të Kryetarit të Doganës Vlorë si akt administrativ i paligjshëm. Detyrimin e palës së paditur, Dega e Doganës Vlorë, të dëmshpërblejë palën paditëse shoqëria Nutri Farm sh.p.k. në shumën 9.868.950 Lekë. Rrëzimin e padisë për pjesët e tjera.”.

5. **Me datë 07.05.2019 Dega e Doganës Vlorë ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.** Në rekurs është kërkuar ndryshimi i dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova.

6. **Në aktin e rekursit pala e paditur ka kërkuar në pjesën hyrëse të objektit të rekursit edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në rekurs nuk ka asnjë bazë ligjore të individualizuar shkaqet e kërkesës për pezullim. Gjithashtu në rekurs nuk ka asnjë argument që të justifikojë kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në rekurs ka të parashtruara vetëm shkaqet që lidhen me vetë rekursin dhe asnjë që lidhet me kërkesën për pezullim.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

8. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

9. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të

ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

10. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

11. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

12. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

13. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

14. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si mjet juridik për të konkuruar ligjërisht rekursin. Në rekurs nuk ka asnjë argument juridik dhe faktik se pse vendimi gjyqësor i formës së prerë duhet të pezullohet. Gjithashtu nuk ka asnjë provë dhe asnjë argument juridik se pse kërkohet të pezullohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe se kush janë pasojat e pariparueshme në rast ekzekutimi të tij. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Degës së Doganës Vlorë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2663, datë 02.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të ndryshuar me Vendimin nr. 885, datë 21.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 26/296 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 296 Akti, datë 21.05.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **Z. Xhavit Bathorja
Z. Sinan Bathorja
Znj. Razije Bathorja
Z. Gersjan Bathorja
Z. Baki Bathorja
Znj. Liljana Bathorja**

OBJEKTI: *Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 490, datë 21.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Prefeti i Qarkut Tiranë**

I PADITUR: **Z. Sinan Bathorja
Z. Zyhdi Bathorja
Znj. Liliana Bathorja
Znj. Flavia Bathorja
Z. Fation Bathorja
Z. Haziz Bathorja
Z. Vehbi Bathorja
Z. Baki Bathorja
Znj. Semiha Bathorja
Z. Xhavit Bathorja
Znj. Razije Bathorja**

Znj. Miranda Bathorja
Z. Gersjan Bathorja
Z. Erdit Bathorja

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 1725 (80-2016-1749), datë 12.04.2016 ka vendosur ndër të tjera: *“1. Pranimin e kërkesë-padisë. 2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 148, datë 06.11.2015 të Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Tiranë. 3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të Ramazan Hazis Bathorja, numër s’ka, datë s’ka, me sipërfaqe totale 35300m², të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës Fshati Farkë e Madhe, në ngastrat si më poshtë: - nr. 1 dhe emërtimin popullor “Kabeti” sipas AMTP me sipërfaqe 13000 m²; - nr. 2 dhe emërtimin popullor “Shapi i Kabetit” sipas AMTP me sipërfaqe 15000 m²; - nr. 3 dhe emërtimin popullor “Ura e Qorrit” sipas AMTP me sipërfaqe 2300 m²; - nr. 4 dhe emërtimin popullor “Fira e Lugut” sipas AMTP me sipërfaqe 5000 m². 4. Kthimin në pronësi të pronarit shtet të sipërfaqes prej 35300 m² të ndodhur në ngastrat si më poshtë: - nr. 1 dhe emërtimin popullor “Kabeti” sipas AMTP me sipërfaqe 13000 m²; - nr. 2 dhe emërtimin popullor “Shapi i Kabetit” sipas AMTP me sipërfaqe 15000 m²; - nr. 3 dhe emërtimin popullor “Ura e Qorrit” sipas AMTP me sipërfaqe 2300 m²; - nr. 4 dhe emërtimin popullor “Fira e Lugut” sipas AMTP me sipërfaqe 5000 m². 5. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit të marrjes së Tokës në Pronësi në emër të Ramazan Hazis Bathorja nr. 276, datë s’ka, me sipërfaqe totale 14900 m², të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës Fshati Lundër në ngastrat si më poshtë: - nr. 1 emërtimi kadastral nr. 540 dhe emërtimi popullor “Kabet” sipas AMTP me sipërfaqe 14900 m². 6. Kthimin në pronësi të pronarit shtet të sipërfaqes prej 14900 m² të ndodhur në ngastrat si më poshtë: - nr. 1 emërtimin kadastral nr. 540 dhe emërtimin popullor “Kabet” sipas AMTP me sipërfaqe 14900 m². 7. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të Ramazan Hazis Bathorja me nr. 233, datë 13.03.2002 me sipërfaqe totale 15500 m² të lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Fshatit Farkë e Madhe në ngastrat si më poshtë: nr. 1 emërtimi kadastral nr. 366 dhe emërtimi popullor “Shtufja” sipas AMTP me sipërfaqe 11000 m²; - nr. 2 emërtimi kadastral nr. 369 dhe emërtimi popullor “Shtufja” sipas AMTP me sipërfaqe 4500 m². 8. Kthimin në pronësi të pronarit shtet të sipërfaqes prej 15500 m² të ndodhur në ngastrat si më poshtë: - nr. 1 emërtimi kadastral nr. 366 dhe emërtimi popullor “Shtufja” sipas AMTP me sipërfaqe 11000 m²; - nr. 2 emërtimi kadastral nr. 369 dhe emërtimi popullor “Shtufja” sipas AMTP me sipërfaqe 4500 m².”.*

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 490, datë 21.02.2019 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1725, datë 12.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 490, datë 21.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs palët e paditura. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. Më datë 21.05.2019 palët e paditura ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Padia duhet të rrëzohej pasi është haptazi e pabazuar në ligj;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të përkeqësonte në mënyrë të menjëhershme gjendjen juridike dhe ekonomike të palëve të paditura;*
- *Toka si pasuri e paluajtshme është lënë si garanci hipotekore dhe ndër vite është tjetërsuar tek persona të tretë;*
- *Mbi këto prona ka masa për shitje në ankand nga shërbimi përmbarimor;*
- *Nga ekzekutimi i vendimit cenohen edhe persona të tretë;*
- *Znj. Liljana Bathorja është e ve dhe ka dy fëmijë të mitur për t'u përkujdesur dhe se ekzekutimi i vendimit do të ishte fatal për këtë familje;*
- *Familja bujqësore ka pasur 12 anëtarë dhe kryefamiljari ka ndërruar jetë me datë 10.08.2000;*
- *Ekzekutimi do të përkeqësonte në mënyrë të menjëhershme dhe të paarsyeshme gjendjen ligjore të palëve të paditura dhe do të sillte dëme të rënda ekonomike;*
- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëherë duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja.*

5. Rezulton se ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se po procedohet për ekzekutimin e tij nga shërbimi përmbarimor gjyqësor.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk

paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palëve të paditura për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 1725 (80-2016-1749), datë 12.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 490, datë 21.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ERVIN PUPE

ILIR PANDA

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 67/376 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën nr. 376 akti, datë 23.07.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **Bashkia Tiranës (Tirana Parking)**

OBJEKTI: *Pezullimi i zbatimit të Vendimit nr. 1411, datë 07.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Z. Bujar Harizi**

I PADITUR: **Bashkia Tiranë (Tirana Parking)**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relativimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethana e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3284, datë 24.07.2017 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit Bujar Harizi. – Detyrimin e palës së paditur, Tirana Parking, pranë Bashkisë Tiranë, t’i paguajë paditësit Bujar Harizi pagën që do të kishte përfituar nga data e ndërprerjes së*

marrëdhënieve të punës 03.04.2017 deri në përfundimin e afatit të kontratës, datë 25.01.2018.- Rrëzimin e kërkimeve të tjera.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1411, datë 07.05.2019** ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 3284, datë 24.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1411, datë 07.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Tirana Parking pranë Bashkisë Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 05.06.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Kërkesa është ndërfutur në aktin dhe tekstin e rekursit. Në të parashtrohet se:

- *Bashkia Tiranë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Pala paditëse nuk i është bindur grafikut të orareve të caktuara nga punëdhënësi dhe ky fakt ka shërbyer për zgjidhjen e kontratës së punës;*
- *Zgjidhja e kontratës së punës është kryer sipas ligjit;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëherë do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve dhe do të jetë objektivisht e pamundur të paguhet pagat për punonjësit;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ”* (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Bashkisë Tiranë (Tirana Parking) kundër Vendimit Nr. 3284, datë 24.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 1411, datë 07.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 141/498 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 498 Prot., datë 15.11.2019, si më poshtë:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

OBJEKTI: *Kërkesë për pezullimin e Vendimit nr. 5356, datë 14.10.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Z. Saimir Boshnjaku**

I PADITUR: **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, **z. Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 1944 (706), datë 14.04.2015 ka vendosur ndër të tjera: “*Rrëzimin e kërkesë-padisë.*”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 5356, datë 14.12.2017 ka vendosur: “*Ndryshimin e Vendimit nr. 1944 (706), datë 14.04.2015 të Gjykatës*

Administrative të Shkallës së Parë. – Pranimin e kërkesëpadisë. – Detyrimin e palës së paditur t'i japë paditësit, Saimir Boshnjaku, gradën policore “Drejtues” dhe ta emërojë në një detyrë funksionale që i korrespondon kësaj grade. – Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.”.

3. Kundër Vendimit nr. 5356, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënia në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

4. Më datë 15.11.2019 pala e paditur ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka nisur dhe rreziku për ekzekutimin e vendimit është i madh, duke krijuar dëme të pariparueshme për palën e paditur dhe interesin publik;*
- *Vendimi i dhënë nga gjykata e apelit ka cenuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe ka shkelur atributin ekskluziv të Policisë së Shtetit për të përcaktuar binomin gradë – funksion në polici;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mundet të sjellë efekte administrative dhe financiare të konsiderueshme për palën e paditur;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Lidhur me pretendimin për rrezikun e shkaktimit të dëmeve të konsiderueshme, Kolegji vlerëson se kjo pjesë e kërkesës nuk është e arsyetuar dhe nuk është e provuar dhe se

si e tillë nuk mundet të vlerësohet se bazohet në standardet ligjore që kërkon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile për t'u pranuar dhe për t'u caktuar nga Gjykata e Lartë një masë procedurale e përkohshme. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012
“Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” dhe Nenin 479 të Kodit të
Procedurës Civile,*

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 1944 (706), datë 14.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 5356, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 144/504 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

SOKOL SADUSHI	KRYESUES
ERVIN PUPE	ANËTAR
ILIR PANDA	ANËTAR

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 504 Regj., datë 21.11.2019, si më poshtë:

KËRKUES: **Z. Petrit Bathorja**

OBJEKTI: *Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1690, datë 25.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 2793, datë 28.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Prefekti i Qarkut Tiranë**

I PADITUR: **Z. Petrit Bathorja**
Z. Dilaver Bathorja
Znj. Adriana Bathorja
Z. Enkel Bathorja
Znj. Jornela Bathorja
Z. Ismail Bathorja
Z. Shyqyri Bathorja
Znj. Zejnepe Maçi

Znj. Kismete Sadiku
Znj. Duhije Metalla

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 1690, datë 25.04.2017 ka vendosur** ka vendosur: “- *Pranimin e kërkesë padisë. – Shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me nr. nuk ka, datë nuk ka, me sipërfaqe totale 36.300 m², në emër të familjes bujqësore me përfaqësues Ferit Hazis Bathorja, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Farkë e Madhe, Njësia Administrative Farkë. – Kthimin në pronësi shtet të sipërfaqes prej 36.300 m². – Shfuqizimin e Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi me nr. 323, datë 15.08.2002 me sipërfaqe totale 23.640 m², në emër të familjes bujqësore me përfaqësues Ferit Hazis Bathorja, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Farkë e Madhe, Njësia Administrative Farkë. – Shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës Bujqësore në Pronësi AMTP me nr. 277, datë 28.06.2000, me sipërfaqe totale 14.900 m², në emër të familjes bujqësore me përfaqësues Ferit Hazis Bathorja, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Fshatit Farkë e Madhe, Njësia Administrative Farkë. – Kthimin në pronësi të shtetit të sipërfaqes prej 14.900 m². – Shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi me AMTP me nr. 510, datë 19.12.2001, me sipërfaqe totale prej 2000 m², në emër të familjes bujqësore me përfaqësues Ferit Hazis Bathorja, lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së Fshatit Farkë e Madhe, Njësia Administrative Farkë. – Detyrimin e familjes bujqësore të paguajë vlerën e pasurisë së shitur me sipërfaqe 2000 m² në shumën 1.046.000 Lekë.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2793, datë 28.10.2019** ka vendosur: “*Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1690, date 25.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

3. Pala e paditur, z. Petrit Bathorja, me datë 19.11.2019 ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor dhe duke kërkuar ndryshimin e të dy vendimeve dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

4. **Më datë 25.11.2019 pala paditëse, z. Petrit Bathorja, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs dhe pritet të vendosë Gjykata e Lartë;*
- *Ekziston domosdoshmëria e marrjes së masës së pezullimit, pasi ka urgjencë dhe se anulimi i titujve të pronësisë dhe ngarkimi me detyrime financiare i palëve të paditura shkakton pasoja të pakthyeshme;*

- *Vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit janë të pabazuara në ligj dhe në prova, duke lënë shkak për rekurs sipas shkronjës “a” dhe “b” të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile;*
- *Kërkesëpadia e Prefektit ka tejkalar çdo afat ligjor për ngritjen e saj, sipas nenit 10 të Ligjit nr. 9948;*
- *Vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen dhe duhet të vendoset rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova;*
- *Gjykata e apelit ka lejuar gabime procedurale që kanë shkaktuar proces të parregullt ligjor;*
- *Nuk është e vërtetë që komisionet e tokës dhe ligji për tokën ka pushuar së vepruari në vitin 1998;*
- *Vërtetësia e AMTP nuk mund të vihet të dyshim edhe pse nuk kanë pasur formën e akteve noteriale;*
- *Përfituesi i tokës bujqësore provohet të ketë qenë pronar i tokës që është vënë në dispozicion për themelimin e ndërmarrjes bujqësore;*
- *Pasojat në cenimin e të drejtës së pronësisë së pronarëve do të jenë të pakthyeshme nëse ekzekutohet vendimi, pavarësisht vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë;*
- *Deri në shqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë përfundimisht, vendimet e gjykatave, tashmë të shndërruara në titull ekzekutiv, duhet të pezullohen sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.*

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

5. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

6. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

7. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

8. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

9. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

10. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

11. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës

Civile. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, z. Petrit Bathorja, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 1690, datë 25.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 2793, datë 28.10.2019 e Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 155/521 i Vendimit.

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**SOKOL SADUSHI
ERVIN PUPE
ILIR PANDA**

**KRYESUES
ANËTAR
ANËTAR**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 521 Akti, si më poshtë:

KËRKUES: **Z. Selim Hametaj
Znj. Zonjë Hametaj
Z. Gramoz Hametaj
Znj. Valbona Hametaj
Znj. Enkeleda Hametaj
Znj. Brunilda Hametaj
Z. Ardi Hametaj**

OBJEKTI: *Kërkesë për pezullim ekzekutimi të Vendimit nr. 3613, datë 25.09.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 2822, datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*

BAZA LIGJORE: *Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile*

Në çështjen me palë:

PADITËS: **Prefekti i Qarkut Tiranë**

I PADITUR: **Z. Selim Hametaj
Znj. Zonjë Hametaj
Z. Gramoz Hametaj
Znj. Valbona Hametaj
Znj. Enkeleda Hametaj
Znj. Brunilda Hametaj
Z. Ardi Hametaj**

**PERSONI I TRETË: Agjencia Shtetërore e Kadastrës
Mesaplik sh.p.k.
Avokatura e Shtetit**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

I- Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3613, datë 25.09.2017 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi, Prefekti i Qarkut Tiranë. – Shfuqizimin e pjesshëm të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) pa nr. akti, datë 15.10.1998, me sipërfaqe 5400 m2, në emër të familjes bujqësore të përfaqësuar nga Selim Arshi Ahmetaj (Hametaj), lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Yzberisht, Njësia Administrative Kashar, për sipërfaqen prej 4245 m2. – Kthimin në pronësi shtet të sipërfaqes prej 4245 m2, sipas akt ekspertimit shtesë datë 11.07.2017, të ekspertes Rajmonda Delimurati, e cila bëhet pjesë e këtij vendimi.*”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2822, datë 30.10.2019 ka vendosur: “- *Lënien në fuqi të Vendimit nr. 3613, datë 25.09.2017 të Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë Tiranë.*”.

3. Kundër Vendimit nr. 2822, datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, kanë paraqitur kërkesë për pezullim. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrezimi i padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova.

4. Më datë 18.12.2019 palët e paditura, kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe vendimi i gjykatës së apelit është i pabazuar në ligj dhe se titulli ekzekutiv nuk mundet të ekzekutohet para se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të shprehet mbi themelin e rekursit;*
- *Vendimet janë marrë në kundërshtim me normat procedurale për marrjen e provave dhe në kundërshtim me ligjin material të zbatueshëm për çështjen;*
- *Prona ka qenë pjesëmarrëse e ndërmarrjes bujqësore dhe se ka zërin kadastral “arë”;*
- *Nuk është bazuar vendimi i gjykatave në situatën ligjore që ekzistonte në kohën e marrjes së aktit dhe se vendimet janë të paligjshme;*
- *Ndryshimi i titullaritetit të pronësisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme do të krijonte pasoja të rënda për pronësinë e palëve të paditura dhe se do të cenonte edhe interesat e ligjshëm të personit të tretë, i cili po zhvillon pronën me anën e një kontrate sipërmarrje të lidhur me të paditurit;*
- *Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit do të pamundësonte ndarjen dhe marrjen e pjesëve takuese të pronës sipas kontratës së sipërmarrjes;*

- *Kthimi në gjendjen e mëparshme pas ekzekutimit do të rezultojë i pamundur nëse vendimi titull ekzekutiv do të zbatohet;*
- *Është shkelur neni 1 Protokolli 1 i KEDNJ dhe e drejta për pronë e palëve të paditura në këtë proces;*
- *Vendimi duhet të pezullohet në ekzekutimin e tij, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Njoftimet janë realizuar dhe nuk rezulton të ketë pasur memorie drejtuar gjykatës nga palët e paditura.

6. Personi i tretë, shoqëria Mesaplik sh.p.k., ka parashtruar me datë 31.12.2019 se ekzekutimi i vendimit duhet të realizohet pasi ndryshe shoqërisë i shkaktohen pasoja të rënda, duke qenë se është ndërtuar mbi këtë pronë një objekt shumëkatësh dhe se shoqëria ka kontraktuar me shumë palë të treta. Personi i tretë ka pretenduar se për shkak të familjes Hametaj dhe paqartësisë së situatës së pronësisë po penalizohen shumë edhe blerësit, duke konkluduar se prona është përfituar në mënyrë të padrejtë nga palët e paditura. Personi tretë ka kërkuar rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

II- Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës

Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palëve të paditura për pezullimin ekzekutimit të Vendimit Nr. 3613, datë 25.09.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 2822, datë 30.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ERVIN PUPE

ANËTAR

ILIR PANDA

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 202 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Illir Panda	Anëtar

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesat Nr. 202 Prot., datë 05.03.2020, si më poshtë:

Kërkues: **Bashkia Kamëz**

Objekti: Pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 671, datë 18.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të ndryshuar me Vendimin nr. 1750, datë 07.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Baza ligjore: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Z. Admir Lleshi**

I paditur: **Këshilli i Ministrave
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Bashkia Kamëz**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 80-2016-671, datë 18.02.2016** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë të paraqitur nga paditësi, Admir Lleshi. Detyrimin e palëve të paditura, Këshilli i Ministrave,*

Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe Bashkia Kamëz që të shpronësojë për interes publik pasurinë nr. 20/20 ZK 1649 e llojit tokë “arë” me sipërfaqe 5000 m2 e regjistruar në ZVRPP Tiranë nr. 20/20 ZK 1649, Vol. 7, faqe 159, në emër të paditësit, Admir Lleshi. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Kamëz, që të dëmshpërblejë paditësin, Admir Lleshi, në vlerën 2.165.000 Lekë për pasurinë nr. 20/20 ZK 1649 e llojit tokë “arë” me sipërfaqe 5000 m2 e regjistruar në ZVRPP Tiranë nr. 20/20 ZK 1649, Vol. 7, faqe 159 në emër të paditësit Admir Lleshi. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Kamëz, që t’i paguajë paditësit, Admir Lleshi, kamatat ligjore për shumën 2.165.000 Lekë, sipas normës bazë të interesit të depozitave të shpallura nga Banka e Shqipërisë nga data e shpalljes së këtij vendimi dhe deri në ekzekutimin e tij. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova.”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1750 (86-2019-2016), datë 07.06.2019 ka vendosur: *“1. Ndryshimin e Vendimit nr. 678, datë 18.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. 2. Pranimin e pjesshëm të padisë. 3. Detyrimin e palës së paditur, Bashkia Kamëz që të dëmshpërblejë paditësin, Admir Lleshi, në bazë të VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha baskitë dhe disa komuna” në masën 13.250.000 Lekë për shpronësimin faktik të pasurisë nr. 20/20, ZK nr. 1649, vol. 7, faqe 159, me sipërfaqe 5000 m2, e regjistruar në ZVRPP Tiranë, në emër të paditësit. 4. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit kamatat ligjore të llogaritura mbi shumën 13.250.000 Lekë, sipas normës bazë të interesit të depozitave të shpallura nga Banka e Shqipërisë, nga data e shpalljes së këtij vendimi deri në ekzekutimin e tij. 5. Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera.”.*

3. Me datë 01.07.2019 pala e paditur, Bashkia Kamëz, ka ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, duke parashtruar edhe shkaqet respektive të kundërshtimit ligjor.

4. Me datë 05.03.2020 pala e paditur, Bashkia Kamëz, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ndaj vendimit të gjykatës së apelit është ushtruar rekurs, pasi vendimet janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe se padia duhet të rrëzohet;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit nuk duhet të bëhet ndaj Bashkisë Kamëz por ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve;*
- *Ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka nevojë që ai të mos vazhdojë dhe vendimi të mos ekzekutohet derisa Gjykata e Lartë të shqyrtojë rekursin, pasi pasojat që do të vijnë ndaj Bashkisë Kamëz dhe buxhetit të saj do të jenë të papërballueshme;*
- *Nuk ka zë të planifikuar në buxhet për ekzekutimin e këtij vendimi;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Ekzekutimi i detyrueshëm ka nisur. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve

mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëcastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëcastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar

dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë e palës së paditur dhe debitore e titullit ekzekutiv është i pabazuar në ligj dhe për rrjedhojë kërkesa nuk mund të pranohet. Kolegji konstaton se në kërkesën për pezullim si shkaqe për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë parashtrihen vetëm shkaqet të cilat pala e paditur pretendon se i ka paraqitur në recurs. Legjitimiteti pasiv i të detyruarit dhe vetëm argumentat e pamundësisë së buxhetit nuk mund të shërbejnë të vetme për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Lidhur me shkaqet e tjera, Kolegji vlerëson se nuk mundet që shkaqet e kërkesës për pezullim të jenë po ato që mundet të parashtrihen në recurs, pasi kjo do të cenonte ritin e gjykimit të të dy këtyre mjeteve procedurale dhe se masat e përkohshme do të zevendësonin dhe konkuronin efektet juridike të shqyrtimit në themel të ankimeve dhe të vendimit përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe në Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Bashkia Kamëz, për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 80-2016-671, datë 18.02.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i cili ka lënë në fuqi Vendimin nr. 1750 (86-2019-2016), datë 07.06.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 120/460 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 460/2019**, që i përket:

KËRKUES: Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Abil Tahiraj.
Astrit Tahiraj.

E PADITUR: Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Palët paditëse, Abil Tahiraj dhe Astrit Tahiraj, i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 1769, datë 22.12.2015, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadiisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të pajisin me certifikatë pronësie z. Abil Tahiraj dhe Astrit Tahiraj për pasurinë sipas vërtetimit hipotekor pasuria me nr. 1/553 dhe me nr. 1/554, e llojit truall, e ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 3682, me sipërfaqe për secilën 150 m² dhe sipërfaqe 300 m², Ura Vajgurore, Berat.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të fshijnë regjistrimin e pasurisë me nr. 1/721, vol. 8, faqe 67, dhe me nr. 1/722, vol. 7, faqe 64, Zona Kadastrale nr. 3682, Ura Vajgurore, të regjistruar mbivendosje dhe regjistrimin e saj në favor të shtetasve z. Abil dhe Astrit Tahiraj.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik administrativ të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në referencën e hapur kartelë pasurie, për pasurinë e sipërcituar nga Kompania e Regjistrimit Fillestar, ku rezulton mbivendosje.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1769, datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

4. Kundër vendimit nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, së bashku me rekursin, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1769, datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë dhe ekzekutimi i vendimit nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, do të sillte pasoja të rënda financiare për institucionin tonë.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo

vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për

kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

13. Nga shqyrtimi i shkakut konkret për të cilin pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

14. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1769, datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1866 (86-2019-2150), datë 18.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 139/496 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol SADUSHI
Ervin PUPE
Ilir PANDA**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 496 Prot., datë 15.11.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Autoriteti i Konkurrencës**

Objekti: Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 1964, datë 09.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është lënë në fuqi me Vendimin nr. 1770, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Znj. Alda Milo**

I paditur: **Autoriteti i Konkurrencës**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 1964 (80-2017-1992), datë 09.05.2017** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë. Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti i Konkurrencës, t’i paguajë paditëses, Alda Milo, si dëmshpërblim pagën e 10 muajve, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të*

pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti i Konkurrencës, t'i paguajë paditëses, Alda Milo, dëmshpërblim për pagën e 3 muajve punë, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti i Konkurrencës, t'i paguajë palës paditëse, Alda Milo, pagën e 5 muajve punë si dëmshpërblim për vjetërsinë në punë. Rrëzimin e kërtimeve të tjera padisë, si të pabazuara në ligj dhe në prova.”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1770, datë 11.06.2019** ka vendosur: “- *Lëniën në fuqi të Vendimit Nr. 1964, datë 09.05/2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1770, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Autoriteti i Konkurrencës. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me të njëjtin akt në të cilin është ushtruar rekursi pala e paditur ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit mundet të sjellë efekte financiare të konsiderueshme për Autoritetin e Konkurrencës e cila nuk ka të parashikuar në buxhetin e saj shuma monetare për të përballuar ekzekutimin e vendimit;*
- *Vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit

gjqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Kolegji konstaton se pala e paditur ka parashtruar në kërkesën për pezullim vetëm shkaqet për të cilat mjeti i duhur i ankimit është rekursi dhe se në këto kushte nuk mundet që kërkesa për pezullim të zëvendësojë apo të dublojë efektet juridike të rekursit dhe se këto shkaqe do të shqyrtohen sipas rregullave të zakonshme të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

14. Lidhur me pretendimin e Autoritetit të Konkurrencës për rrezikun e shkaktimit të dëmeve të konsiderueshme, Kolegji vlerëson se kjo pjesë e kërkesës nuk është e arsyetuar dhe nuk është e provuar dhe se si e tillë nuk mundet të vlerësohet se bazohet në standardet ligjore që kërkon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile për t'u pranuar dhe për t'u caktuar nga Gjykata e Lartë një masë procedurale e përkohshme. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor tashmë të formës së prerë duhet të rrëzohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 1964 (80-2017-1992), datë 09.05.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 1770, datë 11.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 122/462 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 462/2019**, që i përket:

KËRKUES: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 129, datë 28.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Lelja Hafizi, Elida Shehu, Sulejman Shehu, Agron Shehu, Eqrem Kavaja, Muhamed Kavaja, Mjeldina Nallbani, Lantan Kavaja, Afërdita Shehu, Erli Shehu.

E PADITUR: Agjencia e Trajtimit të Pronave.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Palët paditëse i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për vlerësimin financiar të palës së paditur, për kompensimin e tyre si trashëgimtarë të ish pronarit Shuaip Shehu.

2. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 129, datë 28.05.2019, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë.*
- *Ndryshimin e vlerësimit financiar të kryer nga Agjencia e Trajtit të Pronave për sipërfaqen 2648 m², trajtuar me Vendimin nr. 238, datë 11.07.2000, të ish Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia Tiranë.*
- *Detyrimin e Agjencisë së Trajtit të Pronave të kompensojë financiarisht trashëgimtarët e ish-pronarit Shuaip Shehu, në shumën 79.959.008 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetë) lekë.*
- *Ky vendim përbën titull ekzekutiv.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit Agjencia e Trajtit të Pronave.*

4. Kundër vendimit nr. 129, datë 28.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia e Trajtit të Pronave, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në kë të gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Pala e paditur, Agjencia e Trajtit të Pronave, së bashku me rekursin, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 129, datë 28.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i vendimit të mësipërm do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme ndaj Agjencisë së Trajtit të Pronave, të cilat do të vështirësonin dhe pamundësonin ushtrimin e aktivitetit të saj.
- Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në kundërshtim me ligjin material, si rrjedhojë e analizës jo të drejtë të provave dhe zbatimit jo korrekt të ligjit.
- Ekzekutimi i vendimit gjyqësor në favor të paditësit, pa u shqyrtuar paraprakisht rekursi nga Gjykata e Lartë, do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për palën kërkuese, pasi kemi të bëjmë me një vlerësim financiar të një sipërfaqe prej 2.648 m², të vlerësuar trull nga gjykata, ndërkohë që nga ATP është vlerësuar si tokë bujqësore dhe, ndryshimi në vlerën përfundimtare, duke marrë parasysh ndryshimin e zërit kadastral të kësaj prone, është i konsiderueshëm.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë

mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj. Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullim, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, premisën e parë të bazueshmërisë në ligj ka objektin, që do të thotë vendimin gjyqësor të formës së prerë. Në rastin konkret objekti i kërkesës nuk rezulton të jetë vendim gjyqësor i formës së prerë.

14. Së pari, neni 451, shkronja “ç”, i Kodit të Procedurës Civile, parashikon se:

“Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur:

...ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.”.

15. Në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit, sipas nenit 29 të Ligjit nr. 133/2015, e ka gjykuar çështjen si gjykatë e shkallës së parë, duke ushtruar juridiksion fillestar.

16. Së dyti, sipas nenit 5 pika 17 e Ligjit nr. 133/2015 *“Vendim përfundimtar”* është çdo vendim administrativ ose gjyqësor i cili nuk i nënshtrohet më një procedure kontrolli dhe rishikimi nga një autoritet më i lartë administrativ ose gjyqësor, duke përfshirë këtu vendimet e formës së prerë dhe kur këto i janë nënshtuar rekursit, si përfundimtar konsiderohet vendimi i Gjykatës së Lartë. Më tej, neni 30 i Ligjit nr. 133/2015 parashikon se:

“1. Kur vendimi i marrë, sipas këtij ligji, bëhet përfundimtar, Agjencia ose çdo palë e interesuar e dërgon atë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrim.

2. Për vendimet që nuk u është dhënë formë e prerë, për shkak të ndryshimeve të ligjit, Agjencia verifikon nëse është bërë ankim brenda afatit ligjor dhe, në rast të kundërt, këto vendime konsiderohen të formës e prerë.”.

17. Kjo do të thotë se vendimi gjyqësor objekt rekursi në këtë rast nuk është i formës së prerë. Për rrjedhojë kërkesa nuk duhet të pranohet për gjykim. Përsëritja nga ana e kërkuarit e një kërkesë të tillë në të ardhmen do të përbëjë shkak ligjor për zbatimin e sanksionit procedural të parashikuar nga pika 1 e nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Agjencia e Trajtimit të Pronave, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 129, datë 28.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 133/478 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 478/2019**, që i përket:

KËRKUES: Bashkia Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 1356 (1379), datë 04.04.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me vendimin nr. 2209, datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Guri Dulellari.

E PADITUR: Bashkia Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse, Guri Dulellari, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dëmshpërblimin për për pasurinë e tij të zënë nga ndërtimi i Bulevardit “Zhan D’Ark”, Tiranë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1356 (80-2017-1379), datë 04.04.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paraqitur nga Guri Dulellari.*
 - *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë që të dëmshpërblejë paditësin në shumën 812.748 (tetëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për pasurinë me nr. 6/442, me sip. 31.90 m², e llojit truall, ZK 8150, e zënë nga ndërtimi i bulevardit “Zhan D’Ark”, Tiranë.*
- Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2209, datë 11.07.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1356 (80-2017-1379), datë 04.04.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 2209, datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1356 (80-2017-1379), datë 04.04.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Bashkia Tiranë, në datën 25.10.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1356 (80-2017-1379), datë 04.04.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2209, datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material.
- Padia e palës paditëse rezulton të jetë parashkruar.
- Nuk provohet pronësia e paditësit mbi pronën e shpronësuar në kohën e kryerjes së projektit.
- Paditësi nuk mund të kërkojë shpërblimin e dëmit pasi mungon paligjshmëria e veprimit të Bashkisë Tiranë, lidhja shkakësore si dhe faji.
- Paditësi nuk mund të ngrejë një padi të tillë në këtë rast sepse nga pala e paditur nuk është bërë shpronësim.
- Nuk mund të konstatohet dhe të bëhet dhënia e një shpërblimi për një shpronësim de facto pasi gjykata nuk mund të urdhërojë që titulli i pronësisë të kalojë nga pronari tek shteti kundrejt shpërblimit.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të ndikojë në buxhetin e miratuar për institucionin, duke sjellë efekte financiare për Bashkinë e Tiranës.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1356 (80-2017-1379), datë 04.04.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2209, datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 127/468 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më datë **01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me Nr. **Akti 468/2019**, që i përket:

KËRKUES: Bashkia Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 6278, datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar pjesërisht me vendimin nr. 2008, datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Mirela Spahiu.

E PADITUR: Bashkia Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse, Mirela Spahiu, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, ka vendosur:

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 6278, datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:*
 - *Pranimin e pjesëshëm të padisë;*
 - *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësen Mirela Spahiu me 2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuar;*
 - *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 2 (dy) paga mujore si dëmshpërblim për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;*
 - *Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditëses 2 (dy) paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit;*
 - *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër;*
 - *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.*

4. Kundër vendimit nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala paditëse, Mirela Spahiu, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Nuk rezulton që pala e paditur, Bashkia Tiranë, të ketë paraqitur rekurs kundër vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Pala e paditur, Bashkia Tiranë, në datën 14.10.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Bashkia Tiranë nuk ka legjitimitet pasiv në këtë gjykim, pasi pala paditëse ka qenë punonjëse e Bordit të Kullimit dhe jo e Bashkisë Tiranë.
- Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015, nuk rezulton që të jetë vendosur transferimi i personelit nga Bordet e Kullimit pranë bashkive përkatëse.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të ketë efekte financiare të konsiderueshme për Bashkinë e Tiranës.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

13. Ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

14. Nga materialet e kërkesës për pezullim të paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, nuk rezulton që pala kërkuese, Bashkia e Tiranës të ketë ushtruar rekurs kundër vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon në paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

15. Bërja e rekursit kundër një vendimi të formës së prerë përbën kushtin legjitimues për një prej palëve në proces, me qëllim që ajo të ketë të drejtë për të kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë është një kërkesë e prejardhur ose aksesore e rekursit të paraqitur kundër këtij vendimi. Gjithashtu, mungesa e rekursit nga pala gjyqumbëse tregon mungesën e interesit të ligjshëm të kësaj pale për të kundërshtuar një vendim të formës së prerë të dhënë kundër saj.

16. Pavarësisht nga çka u tha më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, edhe nëse do të shqyrtohej në themel, nuk do të përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Shkaqet e parashtruara në këtë kërkesë ose lidhen me pretendimet e parashtruara në rekurs dhe, si të tilla nuk mund të shqyrtohen në këtë fazë të procesit ose nuk mbështeten në prova konkrete që të justifikonin dëmin e rëndë dhe të pariparueshëm të pretenduar nga pala kërkuese.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6278 (80-2016-6302), datë 27.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2008 (86-2019-2316), datë 27.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 147/508 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më datë **01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 508/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 2196, datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr. 6051, datë 16.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Nazxhije Abazi.

E PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse, Nazxhije Abazi, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6051 (80-2016-6103), datë 16.12.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëses Naxhije Abazi.*
- *Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Naxhije Abazi 10 muaj pagë dëmshpërblim, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkak të justifikuar.*
- *Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Naxhije Abazi 3 muaj pagë dëmshpërblim, për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Naxhije Abazi 2 muaj pagë dëmshpërblim, për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palëve të paditura t'i paguajnë paditëses Naxhije Abazi 9.5 muaj pagë shpërblim për vjetërsi në punë.*
- *Rrëzimin për sa u përket kërkimeve të tjera si të pabazuara në ligj dhe në prova.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2196 (86-2019-2562), datë 11.07.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 6051, datë 16.12.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 2196 (86-2019-2562), datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 6051 (80-2016-6103), datë 16.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e çështjes.

5. Pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, në datën 02.12.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6051 (80-2016-6103), datë 16.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2196 (86-2019-2562), datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Zgjidhja e kontratës së punës është bërë duke respektuar procedurën dhe afatin e njoftimit si dhe për shkaqe të justifikuara pasi paditësja ka kryer shkelje të disiplinës në punë.*
- *Jemi në kushtet e nenit 479/a të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë pasi nga ana e zyrës përmbartimore është kërkuar zbatimi i vendimit të gjykatës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme pasi nga bllokimi i llogarive të drejtorisë në bankat e nivelit të dytë do të bllokohej veprimtaria dhe funksionimi normal i institucionit, duke sjellë çorganizim të punës dhe duke i shkaktuar shumë dëme në imazh dhe në vlera monetare.*

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për

pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se pala tjetër pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, është njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk ka parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tij.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e punëtorëve të Qytetit, e Bashkisë Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6051 (80-2016-6103), datë 16.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2196 (86-2019-2562), datë 11.07.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 36/311 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Illir Panda	Anëtar

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 311 Akti, datë 30.05.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Bashkia e Tiranës**

Objekti: Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 641, datë 06.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, që ka ndryshuar Vendimin nr. 3136, datë 20.06.2016

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Connex sh.p.k.**

I paditur: **Bashkia Tiranë**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3136, datë 20.06.2016 ka vendosur ndër të tjera: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë.*”.

2. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 641, datë 06.03.2019 ka vendosur: “*Ndryshimin e Vendimit nr. 3161, datë 20.06.2016 të Gjykatës Administrative të*

Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë të paguajë palës paditëse, shoqërisë Conntext sh.p.k., shumën 1.200.000 Lekë, si detyrim kontraktor i papërbushur që buron nga kontrata e prokurimit publik nr. 5333/6, datë 28.05.2015 “Paketa proporcionale e Tiranës” si dhe t’i paguajë kamatat ligjore për vonesën e pagimit të kësaj shume, sipas normave të interesit të Bankës së Shqipërisë.”.

3. Kundër Vendimit nr. 641, datë 06.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia e Tiranës. Në rekurs është kërkuar prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të gjykatës së shkallës së parë.

4. Me datë 30.05.2019 Bashkia e Tiranës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Shoqëria nuk ka përbushur detyrimin kontraktor plotësisht dhe për rrjedhojë mosekzekutimi i detyrimit është ndërmarrë sipas nenit 21 të kontratës;*
- *Nuk ka kryer dizenjimin e hartës dhe nuk ka dorëzuar hartën për prodhim shtypi;*
- *Procesverbali i komisionit i datës 17.09.2015 nuk do të thotë se marrja në dorëzim e produktit është pranuar pa kontestime, duke qenë se nga moment i marrjes në dorëzim e deri në momentin e konstatimit të të metave kërkohet një kohë e arsyeshme për kryerjen e ekzaminimeve;*
- *Shkresat e përdorimit të hartës e marrë nga Bashkia Tiranë dhe nga rrjetet sociale nuk do të thotë se ajo është origjinale dhe se detyrimi i paditësit është përbushur;*
- *Me datë 20.10.2015 është njoftuar shoqëria nga Bashkia Tiranë për marrjen mbrapsht të produktit dhe se sakaq nuk mund të konsiderohet se produkti është pranuar nga Bashkia Tiranë;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkisë Tiranë për pezullimin e Vendimit Nr. 3136, datë 20.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr. 641, datë 06.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 43/322 I Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 322 Akti, datë 06.06.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Bashkia Tiranës**

Objekti: Pezullimi i zbatimit të Vendimit nr. 1586, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 896, datë 21.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës:

- Z. Kadri Vladi**
- Z. Tahir Vladi**
- Z. Petrit Vladi**
- Znj. Anjeza Karajani**
- Z. Ilir Karajani**
- Znj. Silvana Shima**
- Znj. Nexhmije Bakalli**
- Z. Tefik Shima**
- Znj. Deje Luli**
- Z. Fatos Shima**
- Z. Vahid Shima**
- Z. Edmond Shima**
- Z. Tahsim Shima**
- Znj. Edleva Velia**
- Znj. Bukuriye Hysa**
- Z. Leonard Shima**
- Znj. Zerina Shima**
- Z. Bledar Shima**
- Znj. Eglantina Shima**

Znj. Kejdi Vladi
Znj. Fatbardha Koci
Znj. Myzejen Tomini

I paditur: **Bashkia Tiranë**
Ministria e Brendshme
Këshilli i Ministrave

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 1586, datë 26.04.2018** ka vendosur ndër të tjera: *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësat për zënie/heqjen e së drejtës së pronësisë së paditësave mbi 124 m2 tokë pjesë të pasurisë me nr. 6/314 në vlerën 23703 Lekë/m2, në total dëmshpërblimin e të gjithë bashkëpronarëve me 2.939.172 Lekë. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësat për zënie/heqjen e së drejtës së pronësisë së paditësave mbi 533 m2 tokë në pasurinë me nr. 6/315 në vlerën 23702 Lekë/m2 të zënë në total, dëmshpërblimin e të gjithë bashkëpronarëve me 12.633.699 Lekë/m2. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë të dëmshpërblejë paditësat për zënie/heqjen e së drejtës së pronësisë së paditësave mbi 128.6 m2 në pasurinë nr. 6/313 në vlerën 23703 Lekë/m2 të zënë në total, dëmshpërblimin e të gjithë bashkëpronarëve me 3048206 Lekë. Rrëzimin e padisë për të paditurit Ministria e Brendshme dhe Këshilli i Ministrave.”.*

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 896, datë 21.03.2019** ka vendosur: *“Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1586, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 896, datë 21.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Bashkia Tiranë. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj.

4. **Me datë 06.06.2019 Bashkia Tiranë ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Bashkia Tiranë ka ushtruar rekurs kundër vendimit dhe çështja pritet të gjykohet në Gjykatën e Lartë;*
- *Ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv ka nisur dhe se ka rrezik që vendimi të ekzekutohet edhe pse është marrë në kundërshtim me ligjin;*
- *Vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe me provat e administruara në gjykim;*
- *Ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të pamundësojë funksionimin e institucionit;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbaruesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar e më tej ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për

pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se shkaqet e rekursit janë paraqitur si shkaqe të kërkesës për pezullimin e vendimit të formës së prerë dhe për rrjedhojë kërkesa për pezullim nuk paraqet shkaqe të përligjura dhe që mundet të shqyrtohen në këtë gjykim të posaçëm të masave të përkohshme procedurale. Nga ana tjetër pala kërkuese nuk paraqiti asnjë provë dhe argument që të bazonte pretendimin për dëm të riparueshëm që vjen nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor i formës së prerë. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mundet të pranohet, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Bashkisë Tiranë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 1586, datë 26.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që është lënë në fuqi me Vendimin nr. 896, datë 21.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 130/475 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më datë **01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me Nr. Akti **475/2019**, që i përket:

KËRKUES: Ndërmarrja “MEICO”.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 134 (80-2017-153), datë 26.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2470, datë 19.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Medi Koçiaj.
Mbarime Koçiaj.
Valbona Zane (Koçiaj).
Arjola Perisnaka (Koçiaj).
Reshmiko Tabaku (Koçiaj).
Myrtezan Koçiaj.
Aurel Koçiaj.
Arsed Koçiaj.

TË PADITUR: Këshilli i Ministrave.
Ministria e Mbrojtjes.
Shoqëria “Albademil” sh.p.k.
Ndërmarrja shtetërore “MEICO”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Palët paditëse i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit jopasuror për shkak të vdekjes së të afërmes së tyre, të ndjerës Rajmonda Durdaj si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më datë 15.03.2008.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 134 (80-2017-153), datë 26.01.2017, ka vendosur:

- *Pranimin e padisë së palës paditëse.*
- *Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k., që solidarisht të shpërblejnë dëmin jopasuror moral dhe ekzistencial ndaj shtetasve Medi dhe Mbarime Koçiaj, prindër të shtetases Rajmonda Duda si dhe secilit prej vëllezërve dhe motrave të shtetases Rajmonda Duda, përkatësisht Valbona Zane, Arjola Perisnaka, Reshmiko Tabako, Myrtezan Koçiaj, Aurel Koçiaj dhe Arsed Koçiaj, si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më 15.03.2008, në masën 3.201.950 (tre milion e dyqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë për secilin nga paditësit, pra gjithsej në shumën 25.615.600 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.*
- *Shpenzimet gjyqësore dhe ato në fazën e ekzekutimit u ngarkohen palëve të paditura.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2470, datë 19.09.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 134, datë 26.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 2470, datë 19.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 134 (80-2017-153), datë 26.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, në datën 21.10.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 134 (80-2017-153), datë 26.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2470, datë 19.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ne si palë e paditur nuk kemi legjitimitet pasiv në këtë proces gjyqësor për tu përgjigjur për dëmin që mund tu ketë ardhur paditësve.
- Përlllogaritja e bërë nga eksperti në aktin e ekspertimit është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën dhe ne e kemi kundërshtuar.
- Nga ana e shërbimit përmbartimor ndaj Ndërmarrjes “MEICO” janë duke u ekzekutuar shumë prej vendimeve të proceseve gjyqësore të familjarëve të Gërdecit dhe, nëse do të vazhdohet me këtë ritëm, nisur edhe nga vlerat e larta të dëmshpërblimeve, kjo ndërmarrje do të shkojë drejt falimentimit.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për Ndërmarrjen “MEICO” dhe rregullimi i këtyre pasojave do të ishte tepër i vështirë nëse Gjykata e Lartë do të konstatonte shkeljet e pretenduara nga ana jonë.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtuara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk kanë parashtuar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtuar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Ndërmarrja “MEICO”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 134 (80-2017-153), datë 26.01.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2470, datë 19.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 135/488 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Irir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 01.06.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 488/2019**, që i përket:

KËRKUES: Ndërmarrja “MEICO”.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2562 (86-2019-2919), datë 26.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Lubjana Behra.

TË PADITUR: Këshilli i Ministrave.
Ministria e Mbrojtjes.
Shoqëria “Albademil” sh.p.k.
Ndërmarrja “MEICO”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse, Lubjana Behra, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shpërbelimin e dëmit pasuror dhe jopasuror për shkak të plagosjes së rëndë të paditëses si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më datë 15.03.2008.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditëses Lubjana Behra.*
- *Detyrimin solidarisht të palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k., t’i shpërblejnë paditëses Lubjana Behra vlerën e dëmit të shkaktuar si vjon:
Dëmi pasuror në vlerën 4.452.960 lekë;
Dëmi jopasuror shëndetësor (dëm biologjik) në vlerën 4.452.960 lekë;
Dëmi jopasuror moral në vlerën 2.226.480 lekë.
Dëmi jopasuror ekzistencial në vlerën 2.226.480 lekë.*
- *Detyrimin solidarisht të palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k., t’i paguajnë paditëses Lubjana Behra shpenzimet për rehabilitimin psikologjik nëpërmjet seancave rehabilituese nga psikologu për një periudhë 6 vjeçare, në shumën 432.000 lekë.*
- *Rrëzimin për pjesën tjetër si e pabazuar në ligj dhe në prova.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2562 (86-2019-2919), datë 26.09.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 2562 (86-2019-2919), datë 26.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, në datën 05.11.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2562 (86-2019-2919), datë 26.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ne si palë e paditur nuk kemi legjitimitet pasiv në këtë proces gjyqësor për tu përgjigjur për dëmin që mund tu ketë ardhur paditësve.
- Përlllogaritja e bërë nga eksperti në aktin e ekspertimit është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën dhe ne e kemi kundërshtuar.
- Nga ana e shërbimit përmbartimor ndaj nesh janë duke u ekzekutuar shumë vendime dhe, nëse do të vazhdohet me këtë ritëm, nisur edhe nga vlerat e larta të dëmshpërblimeve, kjo ndërmarrje do të shkojë drejt falimentimit.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për Ndërmarrjen “MEICO” dhe rregullimi i këtyre pasojave do të ishte tepër i vështirë nëse Gjykata e Lartë do të konstatonte shkeljet e pretenduara nga ana jonë.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për

pezullim. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese dhe nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

13. Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se kjo kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese.

15. Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumente dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Ndërmarrja “MEICO”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5718 (80-2016-5794), datë 01.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2562 (86-2019-2919), datë 26.09.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 01.06.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 80/397 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën nr. 397 Akti, datë 19.08.2019 dhe kërkesën nr. 477 Prot., datë 22.10.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Komisioni i Prokurimit Publik**
Avokatura e Shtetit

Objekti: Pezullimin e Vendimit nr. 1842, datë 13.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes nga Gjykata e Lartë.

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Paditës: **Z. Spiro Kuro**

I paditur: **Këshilli i Ministrave**
Komisioni i Prokurimit Publik

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. Para Gjykatës së Lartë janë paraqitur dy kërkesa për pezullim, respektivisht nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa nr. 397 Akti, datë 19.08.2019 dhe nga Avokatura e Shtetit kërkesa nr. 477 Prot., datë 22.10.2019 (e paraqitur kjo e fundit në rekurs). Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke qenë se ato janë paraqitur kundër të njëjtit vendim gjyqësor të formës së prerë, bazuar në nenin 55, 448 dhe 480 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur t'i bashkojë ato një gjykim të vetëm.

2. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3812 (80-2017-3897), datë 09.10.2017** ka vendosur ndër të tjera: “- *Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova.*”.

3. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1842, datë 13.06.2019** ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 3812, datë 09.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e të paditurit KPP t'i paguajë pagën paditësit deri në mbarimin e afatit 5 vjeçar (nga data 28.12.2016 e largimit pjesa e mbetur, deri në datë 26.11.2019 me mbarimin e afatit të plotë), duke zbritur çdo lloj përfitimi të paditësit, Spiro Kuro, për shkak të punësimit të tij në këtë periudhë.*”.

4. Kundër Vendimit nr. 1842, datë 13.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit. Në rekurs është kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. **Me datë 19.08.2019 Komisioni i Prokurimit Publik ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në vlerësim të keq të provave dhe se ekzekutimi i tij do të sjellë dëme të pariparueshme për institucionin;*
- *Gjykata ishte e detyruar të zbatonte dhe të kishte parasysht Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 953 dhe se nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm;*
- *Vendimi i gjykatës së apelit nuk është gjë e gjykuar dhe se para se të ekzekutohet duhet të pritet të ushtrohet kontrolli i ligjshmërisë edhe nga Gjykata e Lartë;*
- *Buxheti i institucionit nuk ka fonde për të përballuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor dhe se punëdhënësi në këtë rast nuk është Komisioni i Prokurimit Publik por Këshilli i Ministrave;*
- *Në vendimin e gjykatës është ngatërruar shuma që institucioni punëdhënës duhet të paguaj, duke mos u vendosur nëse pagat që do të paguhen janë në vlerën bruto apo neto;*
- *Mandati i paditësit ka mbaruar dhe se në këto kushte ai nuk mundet të paguhet më dhe se në këtë mënyrë duke u shkelur ligji i shkaktohet shtetit një dëm i parikuperueshëm financiar;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga kolegji administrativ i gjykatës së lartë.*

6. **Bashkë me rekursin Avokatura e Shtetit ka kërkuar edhe pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me provat që janë administruar gjatë gjykimit;*
- *Ekzekutimi i vendimit të gjykatës së apelit mundet të sjellë dëme të pariparueshme për palën e paditur, pasi kemi të bëjmë me një shumë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit;*
- *Në rast ekzekutimi do të ishte i pamundur kthimi i shumave;*
- *Vendimi gjyqësor i formës së prerë duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

7. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimin administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

11. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret

ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës për pezullim të Avokaturës së Shtetit dhe Komisionit të Prokurimit Publik kundër Vendimit nr. Nr. 3812 (80-2017-3897), datë 09.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të ndryshuar me Vendimin nr. 1842, datë 13.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ILIR PANDA

ANËTAR

ERVIN PUPE

KRYESUES

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 83/402 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 402 Akti, datë 22.08.2019, si më poshtë:

Kërkues: **Autoriteti Rrugor Shqiptar**

Objekti: Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 1542, datë 20.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është vendosur ndryshimi i Vendimit nr. 534 (80-2017-522), datë 16.02.2017 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimi i pjesëshëm i kërkesë padisë

Baza ligjore: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Z. Tonin Loci**

I paditur: **Autoriteti Rrugor Shqiptar**

Ndërhyrës kryesor: **Znj. Pashke Loci**
Z. Emanuel Loci

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relativin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Nr. 534 (80-2017-522), datë 16.02.2017** ka vendosur ndër të tjera: “1. *Rrëzimin e kërkesë – padisë....*”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 1542, datë 20.05.2019** ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 534 (80-2017-522), datë 16.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Pranimin pjesërisht të kërkesë – padisë. – Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësin, Tonin Loci, për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën 3.916.911 Lekë. – Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, të paguajë dëmin material të mjetit tip Benz Mercedes me targa AA 763 AG në shumën 420.000 Lekë. – Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj. – pranimin pjesërisht të padisë së ndërhyrësve kryesor. – Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësen/ndërhyrësen kryesore, Pashke Loci, për dëmin jopasuror në shumën 886.500 Lekë. – Detyrimin e palës së paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar, të dëmshpërblejë paditësin/ndërhyrës kryesor, Emanuel Loci, për dëmin jopasuror në shumën 886.500 Lekë. – Rrëzimin e padisë së ndërhyrësve kryesor për pjesën tjetër të saj.”.*

3. Kundër Vendimit nr. 1542, datë 20.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Në rekurs është kërkuar ndryshimi i vendimeve të të dy gjykatave të faktit dhe rrëzimi i padisë si e pabazuar në ligj dhe në prova.

4. **Me datë 22.08.2019 Autoriteti Rrugor Shqiptar ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.** Në kërkesë parashtrohet se:

- *Duke qenë se kanë nisur procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm dhe çështja pret një zgjidhje përfundimtare, atëhere duhet që Gjykata e Lartë të pezullojë vendimin gjyqësor të formës së prerë, derisa të zgjidhet çështja;*
- *Nuk plotësohen në mënyrë kumulative 4 elementët e ekzistencës së demit jashtëkontraktor dhe të përgjegjësisë civile të organit shtetëror;*
- *Akti i ekspertimit nuk është realizuar sipas përcaktimeve ligjore, konkretisht nenit 17 të Rregullores së AMF ku jepet koeficienti i paaftësisë për punë;*
- *Nuk ka prova që paaftësia prej 25 % për punë ka ardhur vetëm si pasojë e aksidentit;*
- *Nga vërtetimi i punës nuk del se paditësi ka pësuar dëm serioz;*
- *Fotot e automjetit kanë të mbuluar targën dhe në këtë mënyrë krijohet një dyshim për vërtetësinë e faktit nëse është ky automjet që është dëmtuar;*
- *Aksidenti automobilistik ka ndodhur si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor të vetë palës paditëse dhe se neni 139 i Kodit Rrugor parashikon se drejtuesi i mjetit duhet të ruajë gjithmonë kontrollin e mjetit dhe të jetë në gjendje të kryejë të gjithë manovrat e nevojshme sipas rrethanave;*
- *Paditësi ka qenë me 90 km në orë dhe se ka qenë duke parakaluar e për pasojë është faji i drejtuesit të mjetit;*
- *Referuar Ligjit nr. 10076/2009 legjitimitetin pasiv e ka Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe jo Autoriteti Rrugor Shqiptar;*
- *Nëse vendimi gjyqësor ekzekutohet atëhere do të rrezikohet veprimtaria e institucionit dhe nuk do munden të përmbushen shërbimet dhe detyrimet ligjore kundrejt qytetarëve;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

5. Rezulton se përmbartuesi gjyqësor ka realizuar njoftimin e debitorit për ekzekutimin vullnetar. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Lartë konstaton se kërkesa përmban të njëjtat shkaqe me rekursin e paraqitura nga palët e paditura kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji sjell në vëmendje se kërkesa për masë të përkohshme procedurale, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundet të shërbejë si procedim apo si mjet për të konkuruar dhe për të dubluar rekursin. Këto procedime janë të ndryshme për nga qëllimet që ndjekin. Vlerësimet e Gjykatës së Lartë mbi rekursin do të realizohen vetëm kur, sipas rregullave të përgjithshme, të gjykohet rekursi. Në gjykimin e masave të përkohshme Gjykata e Lartë fokusohet vetëm në vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret nuk ka asnjë pretendim të parashtruar për kushtet dhe kriteret ligjore të caktimit të masës së përkohshme procedurale. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në pikën 2 të nenit 1 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative dhe në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Autoritetit Rrugor Shqiptar për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 534 (80-2017-522), datë 16.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i ndryshuar me Vendimin nr. 1542, datë 20.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR

ANËTAR

KRYESUES

ILIR PANDA

ERVIN PUPE

SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 74/388 i Vendimit.

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Sot më datë 01.06.2020, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi kërkesën Nr. 388 Prot., datë 06.08.2019; kërkesën nr. 416 Akti, datë 09.09.2019; kërkesën nr. 451, datë 03.10.2019 si më poshtë:

Kërkues: **Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**

Objekti: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 2118, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Baza ligjore: Neni 449 dhe 479/a i Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

Paditës: **Z. Ymer Dakoli
Z. Adem Dakoli**

I paditur: **Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
Avokatura e Shtetit**

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjo i relatimin e gjyqtarit, z. **Sokol Sadushi**, mbi kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë,

VËREN:

1. Rrethanat e çështjes

1. Në këtë çështje ka për gjykim tre kërkesa për pezullim nga tre të paditur dhe kundër të njëjtit vendim gjyqësor të formës së prerë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 55, 57, 159, 448 dhe paragrafi i fundit i nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se konstatoi gjatë gjykimit se ekzistojnë edhe elementet subjektive dhe objektive të koneksitetit ndërmjet tyre dhe se ato janë ushtruar ndaj të njëjtit vendim, vendosi të bashkojë shqyrtimin e kërkesave në një çështje të vetme.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 58, datë 13.01.2014 ka vendosur ndër të tjera: “- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadsisë të paraqitur nga paditësat Ymer e Adem Dakoli. – Detyrimin e të paditurve, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) si dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara që të dëmshpërblejë në mënyrë solidare paditësit Ymer e Adem Dakoli dëmin jashtëkontraktor shumën prej 1.397.653.04 Lekë dhe 5.625,61 Euro. – Detyrimin e palës së paditur, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, të t’iu kthejë paditësave, Ymer dhe Adem Dakoli të ardhurat e krijuara gjatë administrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në shumën 1.738.983 Lekë dhe 6.493.90 Euro. - Rrëzimin e kërkesëpadsisë për pjesën tjetër të objektit të saj, atë të shpërblimit të dëmit moral, si të pabazuar në prova dhe në ligj. – Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësat në shumën 492.000 Lekë u ngarkohen të paditurve në mënyrë të barabartë.”.*

3. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 3555, datë 29.09.2014 ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 58, datë 13.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. – Pranimin e pjesshëm të padsisë. – Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësave prej 11.322.859 Lekë si dhe 13.715 Euro, si pjesë e pashlyer e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga bllokimi i 11 llogarive bankare si dhe i pasurisë Bar Hotel “Advin”. – Rrëzimin e kërkesë-padsisë në lidhje me pjesën tjetër të objektit të padsisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.”.*

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me Vendimin nr. 846, datë 14.11.2017 ka vendosur: “*Prishjen e Vendimit nr. 3555, datë 29.09.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë dhe me tjetër trup gjykues.”.*

5. Gjykata Administrative e Apelit me Vendimin nr. 2118, datë 04.07.2019 ka vendosur: “- *Ndryshimin e Vendimit nr. 58, datë 13.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të padsisë. – Detyrimin e të paditurve, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë që të dëmshpërblejnë në mënyrë solidare paditësat Ymer e Adem Dakoli dëmin jashtëkontraktor në shumën 1.397.653,04 Lekë dhe 5.625,61 Euro. – Detyrimin e palës së paditur, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara që t’ju kthejë paditësave Ymer dhe Adem Dakoli të ardhurat e krijuara gjatë administrimit të pasurive të paluajtshme në shumën 1.738.983 Lekë dhe 6.493,9 Euro. – Detyrimin e palës së paditur Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara që t’ju kompensojë paditësave*

Ymer dhe Adem Dakoli dëmin e shkaktuar nga fitimi i munguar nga mosshfrytëzimi i hotel bar restorant Advin për periudhën 22.08.2011 – 21.06.2013 që ka qenë në administrim të AAPSK në shumën 6.1452.373 Lekë, bazuar kjo në Shtojcën e aktit të ekspertimit të datës 25.06.2019, - Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.”.

6. Kundër Vendimit nr. 2118, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs palët e paditura, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin tërësisht të padisë.

7. Me datë 06.08.2019 pala e paditur, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në vlerësim të keq të provave dhe se ekzekutimi i titullit ekzekutiv në këto kushte do të sjellë dëme të pariparueshme për institucionin;*
- *Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme janë marrë në administrim pas dhënies së vendimit të gjykatës së krimeve të rënda mbi sekuestrimin e pasurive;*
- *Pala paditëse nuk mundet të pretendojë interesa hipotetik të shumave të sekuestruara;*
- *Pjesa më e madhe e kontratave nuk janë prekur dhe janë lënë në fuqi kontratat ekzistuese dhe investimi në depozitë apo bono thesari është diskrecion i agjencisë;*
- *Për llogaritë rrjedhëse nuk mund të paguhen dhe të pretendohen interesa bankare si ato të depozitës;*
- *Lokali ka qenë i mbyllur para se të merrej në administrim nga shteti dhe se aty duhet të kryheshin investime që të vihej në punë;*
- *Eksperti ka marrë në analizë shifrat e fitimit pasi lokali është dorëzuar tek paditësat dhe jo ato që kanë qenë në momentin e marrjes në sekuestrim të pasurisë;*
- *Shumat e përlllogaritura nga Agjencia rezultojnë të jenë 954.919,63 Lekë dhe 2.889.86 Euro dhe se për këtë pjesë të detyrimit pala e paditur është dakord;*
- *Në vendimin e gjykatës që ka vendosur revokimin e masës është kthyer vetëm pasuria e sekuestruar por jo edhe pasuritë që rrjedhin prej tyre;*
- *Nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv do të vijnë pasoja të rënda dhe të pariparueshme për institucionin dhe buxhetin e shtetit;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

8. Me datë 09.09.2019 ka paraqitur kërkesë për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Në kërkesë është parashtruar se:

- *Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk gëzon legjitimitet pasiv në këtë çështje dhe se nuk mund të jetë debitor solidar;*
- *Pala e paditur nuk ka kryer veprime mbi pasurinë në administrim dhe të sekuestruar të palëve paditëse;*
- *Gjykata Administrative e Apelit duhet të mbante parasysh detyrimisht konkluzionet e arritura nga Gjykata e Lartë sipas nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile;*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm do të sillte pasoja të pariparueshme dhe të rënda;*

- Ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë duhet të pezullohet derisa të shqyrtohet rekursi në Gjykatën e Lartë.

9. Me datë 03.10.2019 pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në kërkesë parashtrohet se:

- *Vendimet e gjykatave të faktit janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në vlerësim të keq të provave dhe se ekzekutimi i titullit ekzekutiv në këto kushte do të sjellë dëme të pariparueshme për institucionin;*
- *Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme janë marrë në administrim pas dhënies së vendimit të gjykatës së krimeve të rënda mbi sekuestrimin e pasurive;*
- *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë i paditur në këtë çështje;*
- *DPPPP ka qenë në përmbushje të funksionit ligjor të saj dhe se nuk mund të ketë shkak për përgjegjësi civile;*
- *Nuk plotësohen elementet kumulativ të nenit 608 të Kodit Civil për përgjegjësinë jashtëkontraktore;*
- *Pala paditëse nuk mundet të pretendojë interesa hipotetik të shumave të sekuestruara;*
- *Në vendimin e gjykatës që ka vendosur revokimin e masës është kthyer vetëm pasuria e sekuestruar por jo edhe pasuritë që rrjedhin prej tyre;*
- *Palës paditëse duhet t'i dorëzohen shumat 954.919,63 Lekë dhe 2.889,86 Euro, si fryte pasurie, por jo shuma të tjera dhe se përlllogaritja e bërë nga eksperti dhe gjykata ka qenë e pabazuar në ligj dhe në prova;*
- *Nga ekzekutimi i titullit ekzekutiv do të vijnë pasoja të rënda dhe të pariparueshme për institucionin dhe buxhetin e shtetit;*
- *Nuk ka buxhet të planifikuar për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor dhe se vendimi duhet të pezullohet, deri në shqyrtimin e rekursit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.*

10. Rezulton se ka nisur ekzekutimi i detyrueshëm i titullit ekzekutiv. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur të procedojë me njoftimin e palëve për kërkesën e palës së paditur për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ndërkohë nga aktet e dosjes rezulton se ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit gjyqësor të formës së prerë ka nisur nga shërbimi përmbartimor privat.

2. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

11. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

12. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i

subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

13. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

14. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

15. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

16. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

17. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar

nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

18. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kërkesat për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë janë të pabazuara në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohen. Kolegji konstaton se palët e paditura kanë parashtruar në kërkesën për pezullim vetëm shkaqet për të cilat mjeti i duhur i ankimit është rekursi dhe se në këto kushte nuk mundet që kërkesa për pezullim të zëvendësojë apo të dublojë efektet juridike të rekursit dhe se këto shkaqe do të shqyrtohen sipas rregullave të zakonshme të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

19. Lidhur me pretendimin e kërkuarit për rrezikun e shkakimit të dëmeve të konsiderueshme, Kolegji vlerëson se kjo pjesë e kërkesës nuk është e arsyetuar dhe nuk është e provuar dhe se si e tillë nuk mundet të vlerësohet se bazohet në standardet ligjore që kërkon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile për t'u pranuar dhe për t'u caktuar nga Gjykata e Lartë një masë procedurale e përkohshme. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se kërkesat për pezullimin e vendimit gjyqësor tashmë të formës së prerë duhet të rrëzohen, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE:

*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në Nenin 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012
“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe Nenin
479 të Kodit të Procedurës Civile,*

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesës së Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit Nr. 58, datë 13.01.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me Vendimin nr. 2118, datë 04.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, me datë 01.06.2020

ANËTAR
ILIR PANDA

ANËTAR
ERVIN PUPE

KRYESUES
SOKOL SADUSHI